



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/343
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002540/5

Tiranë ___/___/2020

Lënda: Rekomandim për inspektimin e kryer në seksionet e regjimit të posaçëm të sigurisë së lartë në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale 313 "Jordan Misja", Tiranë dhe Peqin dhe trajtimin të ankesave të marra nga disa të paraburgosur dhe/ose denuar

Drejtuar: Znj. Etilda GJONAJ (SALIU)
Ministër i Drejtësisë

Z. Agim ISMAILI
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

E nderuar znj. Ministre,

Në kuadër të marrjes në trajtim dhe shqyrtimit të ankesave drejtuar institucionit tonë, Avokati i Popullit znj. Erinda Ballanca dhe Komisioneri i MKPT-së znj. Ermonela Xhafa, të shoqëruar nga ndihmëskomisionerët e Mekanizmit Kombëtar¹ z. Besnik Deda, znj. Nertila Qafzezi dhe z. Hazbi Selita, në zbatim të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kryen në datën 08 shtator 2020, një inspektim në ambientet e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave të burgosurve të sigurisë së lartë në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) 313 "Jordan Misja", si dhe në datën 14.09.2020 ndihmëskomisionerët e MKPT-së kryen një inspektim në ambientet e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave të burgosurve të sigurisë së lartë në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Peqin.

¹ Neni 81 i ligjit 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Inspektimi kishte për qëllim verifikimin e kushteve materiale për të burgosurit dhe të dënuarve të transferuar në ambientet e regjimit të posaçëm të sigurisë së lartë (si një eksperiencë e re në sistemin penitenciar) me urdhër të Ministrit të Drejtësisë datë 01.08.2020, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore, trajtimin me dinjitet të të burgosurve dhe të dënuarve me burgim, të cilët janë të dyshuar apo të dënuar me vendim të formës së prerë për veprat penale të përcaktuara në nenin 17/1 të ligjit nr. 81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, në Rregulloren e Regjimit të Posaçëm të Sigurisë së Lartë në IEVP, miratuar me urdhër nr.380, datë 19.07.2019 të Ministrit të Drejtësisë, si dhe në aktet ndërkombëtare të miratuara për këtë qëllim.

Gjithashtu, grupi i inspektimit verifikoi edhe pretendimet e ngritura në ankesën drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit nga Av. Vladimir Meçe, mbrojtësi dhe përfaqësuesi ligjor i të paraburgosurit Emiljano Shullazi, regjistruar më datë 08.08.2020, si dhe ankesat e të dënuarve Arbjon Aliko, regjistruar më datë 01.09.2020 dhe Genci Balla, dërguar nga familjarët me email më datë 11.09.2020, të cilët aktualisht vuajnë dënimin në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë, përkatësisht në IEVP 313 *“Jordan Misja”* dhe IEVP Peqin.

Vlen të theksohet se jo të gjithë elementët e ankesave të paraqitura bëjnë pjesë në kompetencat e Avokatit të Popullit për t’u trajtuar. Në këto kushte, institucioni ka trajtuar këto ankesa përsa ato bëjnë pjesë në mandatin kushtetues e ligjor të tij, e që kanë të bëjnë me kushtet në të cilat këta persona po vuajnë dënimin. Vëmendje të veçantë i kemi kushtuar faktit nëse kushtet garantojnë standardin minimal dhe të paprekshëm të trajtimit njerëzor e me dinjitet të të burgosurve, edhe nën masat e jashtëzakoshme të marra në kushtet e rrezikut të sigurisë publike që justifikon këto masa. Në të njëjtën kohë, Avokati i Popullit konstaton se nuk është në mandatin e institucionit vlerësimi nëse një i burgosur i caktuar duhet apo jo të jetë pjesë e regjimit të posaçëm, dhe as vlerësimi nëse ky regjim duhet të përfshijë vetëm personat e dënuar me vendim të formës së prerë apo edhe të paraburgosurit.

Avokati i Popullit dhe grupi i inspektimit të MKPT, pasi mori informacionin e nevojshëm nga drejtuesit e IEVP-ve respektive lidhur me qëllimin e inspektimit, u njoh me dokumentacionin ligjor për transferimin e personave të burgosur nga seksionet e sigurisë së lartë në seksionet e regjimit të posaçëm të sigurisë së lartë, dhe inspektoi ambientet e regjimit të posaçëm për të burgosurit dhe të dënuarit, gjendjen e kushteve materiale dhe teknike të dhomave të fjetjes, procedurat e ajrimit, llojet e aktiviteteve rekreative që zhvillohen për rehabilitimin psiko-social të tyre, dhomën për takim me avokatët privatë, dhomën për takim me specialistin e edukimit, ambientin e dusheve etj.

Krahas masave të marra nga autoritetet shtetërore të ngarkuara me ligj, si për hartimin dhe miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit të seksioneve të regjimit të posaçëm, nxjerrjen e urdhërave nga Ministri i Drejtësisë mbi kërkesën e arsyetuar të Drejtuesit të Prokurorisë të Posaçme për transferimin e 7 (shtatë) të burgosurve nga

regjimi i sigurisë së lartë për në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë, përzgjedhjen dhe trajnimin e stafeve të sigurisë që kryenin shërbim në këto seksione, informimin e të burgosurve lidhur me të drejtat dhe detyrimet gjatë periudhës së qëndrimit në regjimin e posaçëm, si dhe krijimin e disa kushteve materiale për jetesë normale në dhomat e banimit, gjatë inspektimit u konstatuan një sërë mangësish në këto seksione që kishin të bënin me organizimin e jetës dhe veprimtarisë së përditshme të të burgosurve në regjimin e posaçëm dhe një trajtim në disa aspekte, jo dinjitoz i tyre, që bie ndesh me standardet e përcaktuara në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore², Rregullat Europiane të Burgjeve të miratuara nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës në 11 Janar 2006, Standardet minimale të Rregullave për Trajtimin e të Burgosurve (Nelson Mandela Rules) të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 17 Dhjetor 2015, si dhe rekomandimet e CPT-së gjatë vizitave të kryera në Itali.

Vendimet e GJEDNJ³ në shqyrtimin e disa kërkesave nga të burgosur italianë, të dënuar apo të akuzuar për veprimtari mafioze dhe të mbajtur në Regjimin e Posaçëm, përbëjnë gjithashtu një standard për interpretimin dhe zbatimin e këtyre masave në pajtim me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut për organet shtetërore dhe ato ligjzbatuese të Shqipërisë. Ky standard, duhet të shtrihet si në procesin e hartimit e miratimit të rregullave, por edhe në zbatimin në praktikë të rregullave që rregullojnë veprimtarinë e këtyre seksioneve, me qëllim që masat e marra nga ana e tyre të mos bien ndesh me kërkesat e neneve të KEDNJ për të drejtat dhe liritë e të burgosurve, pavarësisht kufizimeve të të drejtave të tyre gjatë qëndrimit për një periudhë prej një viti (me të drejtë ripërsëritjeje)⁴ në këtë regjim.

Së pari, urdhrat e autoritetit përkatës për kalimin e një apo me shumë të burgosurve në regjimin e posaçëm duhet të konsiderohen si pezullim i përkohshëm i disa të drejtave të cilat aktet ndërkombetare dhe legjislacioni i brendshëm parashikojnë për të burgosurit, për shkak të ruajtjes dhe garantimit të sigurisë publike e konkretisht të cënimit apo mundësisë së cënimit të saj prej veprimtarisë së paligjshme e kriminale që mund të kryhet prej disa personave të ndodhur nën masat e sigurisë personale apo të dënuar për vepra të caktuara në mënyrë specifike në ligj. Kjo do të thotë se, për marrjen e masës së pezullimit të këtyre të drejtave duhet së pari, të ekzistojnë elementët përkatës të parashikuar nga ligji që plotësojnë kushtet e rrezikimit të sigurisë publike (vlerësim i cili kryhet prej strukturave përkatëse të organeve të Prokurorisë dhe Ministrisë të Drejtësisë)

² Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.9137, datë 31.07.1996.

³ Në referim të çështjeve të trajtuara nga GJEDNJ:

1. Marcelo Viola kundër Italisë:

<https://www.jurist.org/commentary/wp-content/uploads/sites/3/2019/10/Judgment-Marcello-Viola-v.-Italy-no.-2-irreducible-life-sentence-breached-the-Convention.pdf>

2. Enea kundër Italisë:

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-94072%22%5D%7D>

⁴ Praktika ka treguar se këto masa për këta të burgosur në vendet e tjera ku janë zbatuar më parë, janë zgjidhur apo rinovuar edhe për periudha të tjera kohore të njëpasnjëshme.

dhe së dyti, të pezullohen ato të drejta që të burgosurit kanë, ushtrimi e gëzimi i të cilave prej këtyre të burgosurve vlerësohet se përbën rrezik për sigurinë publike.

Së dyti, këto masa, duke qenë se përbejnë përjashtim nga të drejtat e garantuara nga Konventa, duhet të kalojnë në tërësinë e tyre testin e proporcionalitetit dhe përputhshmërisë apo përshtatshmërisë me qëllimin për të parandaluar rrezikun që i cënohet rendit dhe sigurisë publike. Në çdo rast, këto masa duhet të jenë të ankimeshme në gjykata dhe gjykata të ketë mundësinë për të shqyrtuar efektivisht përshtatshmërinë e këtyre masave në rastet specifike. Qëllimi i lavdërueshëm që autoritetet publike kërkojnë të arrijnë në këtë rast është shkëputja e lidhjeve midis këtyre të paraburgosurve apo të dënuarve me grupet e tyre kriminale jashtë burgut, në mënyrë që të minimizohet rreziku i kontakteve të tyre me organizata kriminale.⁵ Nën dritën e arritjes së këtij qëllimi, duhet të vlerësohen edhe masat e marra në rastin konkret.

Në kushtet kur legjislatori shqiptar ka parashikuar se, kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë, për vendosjen ose zgjatjen e regjimit të posaçëm, i burgosuri nëpërmjet mbrojtësit të tij ligjor, brenda 20 ditëve duhet ta ankimojë në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, vlerësimi i përputhshmërisë apo përshtatshmërisë së këtyre masave do vlerësohet prej asaj gjykate. Ndërkohë, kushtet fizike dhe garantimi e respektimi i të drejtave të parashikuara në neni 17 të ligjit nr.81/2020, për të burgosurit e vendosur në regjimin e posaçëm, monitorohet nga Avokati i Popullit, për të garantuar që këto kushte apo një pjesë e tyre, nuk përbëjnë trajtim çnjerëzor dhe denigrues për ta. Gjithashtu, në ecurinë e këtyre masave në vende të tjera (rasti i Republikës së Italisë), kushtet e përgjithshme të të burgosurve nën këtë regjim kanë qenë më të mira se sa ato të të burgosurve të tjerë, për shkak se ata kanë qenë të detyruar t'u nënshtrohen periudhave të gjata të izolimit apo mospërfshirjes në aktivitetet sociale me të burgosur të tjerë, nga jashtë këtij regjimi.⁶

Referuar kërkesave të ligjit 108/2019 “Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, i ndryshuar, neni 13, zëvendësuar me ligjin 81/2020 (neni 17, pika 8 dhe 9), kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë, përfaqësuesit ligjorë të të burgosurve të transferuar në regjimin e posaçëm, kanë depozituar kërkesë ankimore në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Ata pretendojnë se forma, përmbajtja dhe

⁵ Shiko *Guide on case-law of the European Convention of Human Rights - Prisoners Rights*, datë 30.04.2020, faqe 89.

⁶ Për më tepër shikoni qarkoren në 35171996 të Autoritetit Italian të Burgjeve pas daljes së Vendimit 351 të vitit 1996 të Gjykatës Kushtetuese Italiane në lidhje me faktin nëse në vetvete ekzistenca e regjimit të posaçëm është në përputhje me kushtetutën apo jo. Ndërsa ekzistenca në vetvete e këtij regjimi nuk përbën parimisht shkelje të Kushtetutës Italiane apo edhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, kushtet fizike duhet të ishin të përshtatshme për të mos krijuar probleme në nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Italisë dhe nenin 3 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ndonëse natyra e vendimarrjeve të sipërcituara dhe efekti që ata mund të kenë në rastin tonë është i ndryshëm, mendojme se trajtimi i bërë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Italisë duhet të merret parasysh në kuadër të gjetjes së asaj praktike si një interpretim në përputhje me parimet e Konventës dhe si një praktikë që në masën më të madhe është pranuar si e drejtë nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.

mënyra e zbatimit të këtij urdhëri, bie në kundërshtim me standardet dhe detyrimet që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare si Konventa Europiane për Mbrotjen e të Drejtave të Njeriut dhe lirive Themelore, Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve Çnjerëzore ose Poshtëruese, rekomandimet e Komitetit të Ministrave të KE për standardet e trajtimit në burgje dhe CPT-së, si dhe jurisprudencës të GJEDNJ-së.

Seksionet e regjimit të posaçëm të krijuara në IEVP 313 dhe IEVP Peqin, ishin të miratuara me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.381, datë 19.07.2019 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.8927/1 prot., datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë “Për klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale”. Infrastruktura e ndërtimit të tyre nuk lejonte asnjë lidhje apo mundësi kontakti me seksionet e tjera.

Pranimi i të dënuarve e të burgosurve në regjimin e posaçëm, ishte bërë në bazë të kërkesave të nenit 38, të ligjit 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, Kreut III të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, të miratuar me VKM nr.437, datë 20.05.2015, si dhe Urdhërave të Posaçëm të Ministrit të Drejtësisë.

Nga intervistat me të burgosurit në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë, rezultoi se ata ishin të informuar nga Komisioni i Pritjes mbi të drejtat e tyre, sipas parashikimit të nenit 17 të ligjit 81/2020, në lidhje me numrin e takimeve dhe telefonatave mujore me familjet e tyre, sendet personale që u lejohen, orarin e veprimeve, kontrollin e korrespondencës, kohën e ajrimit, kuotën ushqimore, vizitat shëndetësore, të drejtën e ankimit dhe regjistrimin e zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave të tyre, etj.

Akomodimi i të burgosurve ishte bërë në dhoma teke dhe në distancë nga njëri-tjetri. Po ashtu, ajrimi si dhe aktivitetet e tjera sipas orarit të veprimeve, kryheshin të veçuara, për të evituar komunikimin mes tyre, por dhe për të parandaluar rrezikun për jetën apo cënimin e sigurisë së tyre. Për këtë qëllim, stafi i këtyre institucioneve kishte bërë vlerësimin e riskut për secilin prej tyre, sipas një formati tip të miratuar në rregulloren e regjimit të posaçëm.

Në kuadër të këtij inspektimi, Avokati i Popullit dhe grupi i punës të MKPT-së, u ndalën kryesisht te kushtet e krijuara në seksionet e regjimit të posaçëm, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me respektimin e të drejtave dhe lirive të të burgosurve, trajtimin me dinjitet të tyre, pavarësisht kufizimit të këtyre të drejtave për një periudhë të caktuar kohore dhe të miratuar me ligj të veçantë. Grupi i punës verifikoi ambientet dhe pajisjen e dhomave me materiale për jetesë dhe akomodim, mbajtjen e higjienës personale të të burgosurve, pastërtinë e ambientit në dhoma dhe ambientet e përbashkëta, pajisjen me sendet personale të secilit prej tyre, frekuentimin e ushqimit, si dhe programet individuale të këshillimit dhe ato me karakter rekreativ për rehabilitimin e këtyre personave.

Nisur nga evidentimi i këtyre kushteve në seksionet e regjimit të posaçëm respektivisht në IEVP 313 “Jordan Misja”, Tiranë dhe IEVP Peqin, situata rezultoi si më poshtë vijon:

Ambientet e seksionit të regjimit të posaçëm në IEVP 313 “Jordan Misja”

1. Në institucionin e sigurisë së lartë IEVP 313 “Jordan Misja”, Tiranë, është ndërtuar e re Godina C me 4 (katër) kate dhe 1 (një) kat përdhe, për seksionin e regjimit të posaçëm të ushtrimin të të drejtave të burgosurve, në të cilën ishin transferuar dhe akomoduar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë 5 (pesë) të paraburgosur. Hyrjet dhe daljet për në godinë, ishin të ndara më vete nga seksionet e tjera që ndodhen në regjimin e brendshëm të këtij institucioni. Kapaciteti zyrtar i godinës ishte për akomodimin e 20-40 personave (një deri në dy persona në dhomë). Qartësisht nuk ishin në kushte të situatës së mbipopullimit.
2. Dy nga personat e burgosur ishin akomoduar në katin e tretë të godinës dhe tre të tjerë ishin akomoduar në ambientet e katit 0 (përdhe) të godinës, secili prej tyre ndodhej në dhoma më vete. Sipërfaqja e dhomës ishte mbi 6 m² dhe kubaturë mbi 9 m³, të nevojshme për një person. Ato ishin të përshtatura për akomodimin e dy personave, por aktualisht në dhomë ndodhej vetëm një person.
3. Dhomat ishin të pajisura me krevat hekuri metalik të fiksuar në dysheme, dyshek, çarçaf, batanije, peshqir personal, një karrige dhe tavolinë për ngrënien e ushqimit me përmasa të vogla rreth 50x30 cm, gjithashtu të fiksuara në dysheme. Nuk kishte orendi të tjera.
4. Siguria e personave që ndodheshin në regjimin e posaçëm dhe gjithë veprimtaria ditore e tyre, kryhej nën mbikqyrjen e stafit të sigurisë të institucionit të trajnuar për këtë qëllim, si dhe survejimit me sistemin e kamerave të vendosura në të gjitha ambientet e këtij regjimi.
5. Dritaret e dhomave ishin me përmasa të mëdha, por depërtimi i ajrit dhe dritës natyrale nuk ishte i mjaftueshëm, për shkak se pengohej nga zgara metalike që ndodhej në pjesën e jashtme të dritareve, e cila ndalonte dhe fushëpamjen me ambientin e jashtëm. Dhomat e ndodhura në katin përdhe kishin fushëpamje dhe mundesi ajrimi edhe më te kufizuar për shkak të pozicionit të tyre. Llambat për ndriçim ishin të montuara në tavan dhe të mbrojtura me zgarë, të paarritshme nga të burgosurit. Çelësi i dritave komandohej nga jashtë dhomës nga personeli i shërbimit të sigurisë.
6. Dhomat e katit 0 (përdhe), në ndryshim nga dhomat e kateve të tjerë, ishin me lagështirë për shkak të punimeve të dobëta që eventualisht ishin kryer në ndërtimin e godinës. Dritaret e dhomave, për shkak të pozicionit nën tokë dhe zgarës metalike, nuk lejonin ajrimin e plotë, depërtonte shumë më pak dritë natyrale se në dhomat e katit të parë dhe nga zgara nuk kishte fushëpamjen në ambientin e jashtëm. Sistemi i ventilimit nuk funksiononte.
7. Në dhoma nuk kishte asnjë orendi tjetër, për të mundësuar mbajtjen e sendeve personale dhe ato mbaheshin në qese të mëdha të vendosura mbi shtratin tjetër të hekurit që gjendej në dhomë.

8. Në çdo dhomë kishte WC e cila kishte ujë të rrjedhshëm dhe ishte e pajisur me një lavaman dhe rubinet, të cilat furnizoheshin deri në 150 litra në ditë për çdo person. Të burgosurit ishin të pajisur me sende personale si sapun për larje, furçë për larjen e dhëmbëve, brisqe dhe sapun për rroje, shapka, si dhe pajisjet e pastrimit si kovë, leckë dhe fshesë. Dhomat mbaheshin pastër nga ana higjieno-sanitare nga vetë të burgosurit, ndërsa ambientet e përbashkëta si korridori, ambienti i dusheve, dhoma për takim me familjarët dhe avokatët, nuk ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, pasi institucioni e kishte të ndaluar të planifikonte personel për pastrimin e tyre, por njëkohësisht ishte i ndaluar pastrimi i tyre edhe nga të paraburgosurit, për shkak të izolimit të tyre edhe brenda ambientit të sigurisë së lartë.
9. Higjena personale e të paraburgosurve mbahej në tualetet që ndodheshin në dhoma, ndërsa larja e trupit kryhej në ambientin e përbashkët të dusheve që ndodhej në çdo kat, në fund të korridorit. Në secilin prej tyre, ndodheshin 6 bokse për larjen e trupit. Larja e trupit zhvillohej rregullisht dhe problemi që ishte shtruar fillimisht në ankesë ishte zgjidhur.
10. Në korridor kishte telefon fiks, me qëllim që të burgosurit të komunikonin me familjet e tyre, sipas rregullores së institucionit dhe në zbatim të urdhërit të Ministrit të Drejtësisë. Ndërsa në çdo dhomë kishte zile në mur, që të paraburgosurit mund të njoftonin shërbimin e sigurisë në rast nevoje.
11. Ajrimi i të burgosurve në regjimin e posaçëm kryhej në gjysmën e sheshit që rrethohej nga tre godinat e tjera në regjimin e brendshëm. Gjysma e sheshit për këtë kategori ishte e ndarë në 4 (katër) bokse ajrimi. Ajrimi realizohej çdo ditë për secilin të burgosur rreth 2 orë në ditë. Bokset e ajrimit ishin me gjatësi dhe gjerësi të mjaftueshme për të kryer lëvizje, ndërsa lart ishin të mbuluar me një rrjetë të lartë për arsye të sigurisë.
12. Ushqimi për të burgosurit në regjimin e posaçëm gatuhej sipas normativave të miratuara në urdhërin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë, njësoj si për të gjithë të burgosurit e tjerë, në 3 vakte dhe sipas orarit të veprimeve. Sipas këtij urdhri të vitit 2006 është miratuar një menu e cila nuk është rishikuar që prej atij viti. Çështja e menisë dhe dietës ushqimore, si dhe nevoja e përmirësimit të saj, kanë qenë objekti i shumë rekomandimeve ndër vite të Avokatit të Popullit, por në rastin konkret çështja merr një rëndësi të veçantë për shkak të pezullimit të disa të drejtave të tjera të të burgosurve të vendësor në regjimin e posaçëm. Kështu, në bazë të ligjit 81/2020, neni 17, të paraburgosurve dhe të dënuarve në regjimin e posaçëm nuk u lejohet të marrin sende, vlera monetare dhe objekte nga jashtë. Më tej, Rregullorja nr. 380, datë 19.07.2019, në nenin 9 ka saktësuar duke kufizuar mundësinë e futjes së çdo lloj ushqimi, pije, fruti dhe ëmbëlsire, por duke lejuar në shtesë nga menuja e sipërcituar 2 kafe në ditë sipas kërkesës së tyre. Nga intervistat me të paraburgosurit, rezultoi se ushqimi nuk ishte i pasur në sasi dhe llojshmëri, pavarësisht se e konsideronin të gatuar në mënyrë të pastër. Ky është një kufizim që ndikon në cilësinë e jetës dhe shëndetit të këtyre personave, në kushtet kur institucioni nuk është në gjendje të sigurojë një ushqim të përshtatshëm apo dieta të caktuara, për shkak të bindjeve personale fetare të të dënuarve në kushtet e regjimit të posaçëm të sigurisë së lartë.

13. Drejtuesit e IEVP "Jordan Misja", na informuan se me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, sipas kërkesës së të burgosurve ishte lejuar futja në regjim e ujit të pijshëm me koli, ndërresave të brendshme dhe veshjeve personale nga familjarët e të burgosurve⁷.
14. Nga intervistat konfidenciale me të burgosurit në regjimin e posaçëm, u ngritën gjithashtu edhe disa pretendime:
- Vizita mjekësore nga stafi i shëndetësisë të institucionit, por dhe nga mjekë specialistë, të kryhej çdo ditë, sipas kërkesave të të dënuarve dhe të burgosurve në lidhje me gjendjen e tyre shëndetësore;
 - Të sigurohet e drejta për t'u informuar, përmes lejimit të televizorit apo radios në dhomë, qoftë dhe me kohë dhe programe të kufizuara, apo dhe gazeta e libra të shkruara, çka mund të jetë dhe një qasje për ri-integrimin edukativ dhe shoqëror të tyre;
 - Të lejohet pastrimi dhe larja e ambienteve të përbashkëta nga personeli institucionit ose nga vetë të paraburgosurit, pasi kishte që nga hyrja e tyre në këtë rregjim, që nuk ishte bërë pastrimi i ambienteve të përbashkëta apo dhe i dusheve;
 - Gjithashtu, ata ngrinin pretendime për ashpërsinë e ligjit apo akteve ligjore në regjimin e posaçëm, pasi hasin vështirësi në zbatim tij dhe kërkonin rishikimin e këtyre akteve.

Ambientet e seksionit të regjimit të posaçëm në IEVP Peqin

1. Në IEVP e sigurisë së lartë Peqin, ishte e përshtatur një prej godinave ekzistuese në regjimin e brendshëm, për seksionin e regjimit të posaçëm të ushtrimin të të drejtave të paraburgosurve, në të cilën ishin transferuar dhe akomoduar me urdhër të Ministrisë të Drejtësisë 2 (dy) të dënuar. Godina ishte me dy kate, ku në secilin kat ndodheshin 10 dhoma banimi, në total 20 dhoma. Kapaciteti zyrtar i godinës ishte për akomodimin e 20-40 personave të dënuar. Hyrjet dhe daljet për në godinë, ishin të ndara nga seksionet e tjera që ndodhen në regjimin e brendshëm të këtij institucioni.
2. Dy nga personat e dënuar ishin akomoduar në katin e parë të godinës, në dhoma më vete dhe në distancë me njëri tjetrin për të mos patur mundësi komunikimi. Siperfaqja e dhomës ishte 6 m² dhe kubaturë 9 m³, të nevojshme për një person. Në kushtet kur dhomat ishin të planifikuara për akomodimin e dy personave, ishte e pamundur jetesa normale e këtyre personave. Në dhomat e katit të parë kishte lagështirë, për shkak të nivelit të ulët të themeleve të ndërtesës.
3. Dhomat ishin të pajisur me krevat hekuri metalik (sistem marinari) të fiksuar në dysheme, dyshek çarçaf, batanije, peshqir personal, një karrige dhe tavolinë për ngrënien e ushqimit me përmasa të vogla, të fiksuara në dysheme.

⁷ Problemet në lidhje me keto dy çështje të ngritura në ankesen e ardhur në institucion kishin gjetur zgjidhje dhe nga inspektimi rezultoi se, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ishte lejuar dërgimi nga familjarët e të burgosurve në seksionet e regjimit të posaçëm, veshje dhe ndërresave të brendshme, si dhe uji i pijshëm me koli.

4. Dritaret e dhomave ishin me përmasa shumë të vogla, të cilat nuk lejonin depërtimin e ajrimit dhe dritës natyrale. Llampat për ndriçim ishin të montuara në tavan dhe të mbrojtura me zgarë, të paarrtshme nga të burgosurit. Çelësi i dritave komandohej nga jashtë dhomës nga personeli i shërbimit të sigurisë.
5. Siguria e të dënuarve që ndodheshin në regjimin e posaçëm dhe gjithë veprimtaria ditore e tyre, kryhej nën mbikqyrjen e stafit të sigurisë të institucionit të trajnuar për këtë qëllim, si dhe survejimit me sistemin e kamerave të vendosura në të gjitha ambientet e këtij regjimi.
6. Në çdo dhomë kishte WC e cila kishte ujë të rrjedhshëm dhe ishte e pajisur me një lavaman dhe rubinet. Dhomat furnizoheshin me ujë me orar 3 herë në ditë, sipas orarit të furnizimit nga Ndërmarrja e Ujësjellësit Peqin. Të dënuarit ishin të pajisur me sende personale si sapun për larje, furçë për larjen e dhëmbëve, brisqe dhe sapun për rroje, shapka, si dhe pajisjet e pastrimit kovë, leckë dhe fshesë.
7. Dhomat e të dënuarve ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, ndërsa ambientet e përbashkëta si korridori, ambienti i dusheve, dhoma për takim me avokatët, nuk ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, pasi institucioni e kishte të ndaluar të planifikonte personel për pastrimin e tyre, por njëkohësisht ishte i ndaluar pastrimi i tyre edhe nga të dënuarit.
8. Në fundin e korridorit të seksionit të regjimit të posaçëm, ndodhej ambienti i përbashkët i dusheve për larjen e trupit. Në secilin prej këtyre ambienteve ndodheshin nga 2 bokse për larjen e trupit. Sipas intervistave me të dënuarit, larja e trupit kryhej 2 herë në javë sipas orarit të veprimeve të miratuar nga drejtori i institucionit.
9. Në korridor kishte telefon fiks, me qëllim që të dënuarit komunikonin me familjet e tyre, sipas rregullores së institucionit dhe në zbatim të urdhërit të Ministrit të Drejtësisë. Ndërsa në çdo dhomë kishte zile në mur, që të dënuarit mund të njoftonin shërbimin e sigurisë në rast nevojë.
10. Ajrimi i të dënuarve në regjimin e posaçëm kryhej përmes bokseve të ajrimit. Në katin e parë ishin përshtatur 10 bokse për ajrim në regjimin e brendshëm. Koha e ajrimit sipas orarit të veprimeve, ishte 1.5 orë në ditë për secilin të dënuar. Bokset e ajrimit ishin me gjatësi dhe gjerësi relativisht të mjaftueshme për të kryer lëvizje, të mbuluar me sgarë hekuri dhe një pjesë me mbulesë në rast shiu.
11. Ushqimi për të dënuarit në regjimin e posaçëm gatuhej sipas normativave të miratuara në urdhërin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë, njësoj si për të gjithë të burgosurit e tjerë, në 3 vakte dhe sipas orarit të veprimeve. Nga intervistat me të dënuarit, u ngrit si shqetësim problemi i ushqimit, pasi ai nuk gatuhej sipas ritit fetar që ata përfaqësonin. Kjo kishte sjellë për pasojë që dy të dënuarit në regjimin e posaçëm të kishin 5 ditë, para ditës së inspektimit, kishin refuzuar marrjen e ushqimit nga guzhina e institucionit.
12. Drejtuesit e IEVP Peqin, na informuan gjithashtu se me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe me kërkesë të të dënuarve ishte lejuar marrja e ujit të pijshëm, me koli, e ndërresave të brendshme dhe e veshjeve personale nga familjarët e tyre.

13. Nga intervistat konfidenciale me të paraburgosurit në regjimin e posaçëm, u ngritën dhe disa pretendime:

- Të lejohet marrja e ushqimit nga familjarët e tyre, ose nga njësia tregtare që ndodhet në institucion, pasi guzhina e institucionit nuk garanton gatimin e ushqimit sipas ritit të besimit të tyre fetar.
- Të lejohet televizori në dhomë ose dhe radio, pasi kanë nevojë të informohen, si një e drejtë themelore e tyre.
- Të diskutohet dhe të ndryshohet në ligj, që telefonatat me familjet e tyre nga një telefonatë në muaj, të bëhen një telefonatë në javë.
- Të lejohen që bisedat dhe takimet me familjarë të kryhen edhe me anëtarë të tjerë të fafësisit si xhaxha, nip apo hallë, jo vetëm me familjarët si babanë dhe nënën, gruan, fëmijët.
- Të zgjatet orari i ajrimit 3-4 orë dhe koha e ajrimit të ndahet një pjesë paradite dhe një pjesë pasdite.

Nga inspektimi rezultoi se, pavarësisht kohës së mjaftueshme në dispozicion nga miratimi i ligjit në vitin 2018 për krijimin e regjimit të posaçëm të sigurisë së lartë, deri në momentin e inspektimit, **nuk ishin marrë masat e duhura** për krijimin e infrastrukturës së nevojshme, për funksionimin e këtyre seksioneve, sipas kërkesave minimaliste të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, të miratuara për këtë qëllim. Në të dy seksionet e krijuara në I EVP 313 dhe I EVP Peqin, mungonin ambientet e veçanta për takim me avokatët mbrojtës, mungonin ambientet apo salla force për ushtrimin fizik të këtyre personave, nuk ishin miratuar ende programet individuale për këshillimin psiko social, si dhe mungonte llojshmëria e librave dhe aktiviteteve rekreative për rehabilitimin dhe ri-integrimin e këtyre personave.

Institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së, nisur nga masat kufizuese të parashikuara në ligjin nr.81/2020 dhe kryesisht në rregulloren e regjimit të posaçëm të sigurisë së lartë, si dhe nga pretendimet për shqetësimet e ngritura në intervistat konfidenciale me të burgosurit që po vuajnë dënimin në kushtet e këtij regjimi, duke i ballafaquar me aktet ndërkombëtare të miratuara për këtë qëllim (kryesisht bazuar në eksperiencën italiane), konstaton se legjislatori shqiptar në disa raste ka parashikuar **masa më të rrepta dhe në tejkalim të standardeve ndërkombëtare**, të cilat çënojnë në disa aspekte parimin e garantimit të trajtimit human dhe me dinjitetit të të burgosurve dhe të dënuarve në këtë regjim.

Pavarësisht eksperiencës së re dhe të pakët në këtë drejtim, është e nevojshme që Regjimit të Posaçëm t'i jepet një aspekt më human duke ndërmarrë hapa për të siguruar që për të gjithë të burgosurit që i nënshtrohen këtij regjimi të gjenden mundësitë për përmirësimin e larmisë së ushqimit, duke mos u kufizuar atyre të drejtën e shijes dhe t'u krijohen kushte për t'ju rritur kohëzgjatjen e ajrimit jashtë qelive të tyre⁸. Po ashtu,

⁸ Si në shembullin e regjimit 41 bis Italian, shih <https://www.crimetalk.org.uk/index.php/library/articles/983-anti-mafia-in-italy-the-41-bis-prison-regime>

duhen gjetur hapësirat për përmirësime ligjore duke shfrytëzuar dhe shembullin e regjimit “41 bis” Italian, lidhur me lejin e televizorit apo radios në dhomë (padyshim me programe dhe kohë të kufizuar)⁹, si një e drejtë themelore e të burgosurve për t’u infomuar, pasi mungesa e stimulimit fizik dhe mendor të të izoluarit, bëjnë që trajtimi kundrejt tyre të jetë degradues, si në aspektin fizik ashtu edhe mendor, duke cënuar rëndë dinjitetin e tyre njerëzor. Institucionet përkatëse ku vuajnë dënimin personat e burgosur në regjimin e posaçëm, kanë detyrimin të planifikojnë dhe të zhvillojnë sa më shumë aktivitete me karakter rekreativ, për rehabilitimin psiko-social dhe ri-integrimin shoqëror të këtyre personave.

Gjithashtu, sa i takon Rregullores së Regjimit të Posaçëm të Sigurisë së Lartë në këndvështrimin e Avokatit të Popullit, vënia e të gjitha parashikimeve në Rrugullore e bën pothuajse të pamundur ndërhyrjen e Gjykatës për të vlerësuar vendimmarrjen, bazuar në parimin e proporcionalitetit apo përshtatshmërisë me rrezikun që duhet mënjanuar, sepse në kushtet kur në aktet rregulluese përcaktohen kushte uniforme për çdo të burgosur të drejtat e të cilit pezullohen përkohësisht, nuk ka hapësirë që i burgosuri të kundërshtojë masat e marra ndaj tij dhe rrjedhimisht nuk ka hapësirë të mjaftueshme ligjore efektive për t’ia nënshtuar vleresimit të Gjykatave masat e marra për secilin rast. Fakti që rregullorja ndalon në mënyrë të veçantë mundësinë e marrjes së ushqimit nga jashtë, nuk duket në pamje të parë si një kufizim që lidhet me qëllimin që legjislatori ka pasur në vendosjen e një përcaktimi të tillë.

Konsolidimi i një sistemi efektiv të ankimimit kërkon që çdo i dënuar dhe i paraburgosur të ketë të drejtën e pacënueshme të ankimimit pranë Avokatit të Popullit apo organizmave të tjera ndërkombëtare në mbrotje të të drejtave dhe lirive themelore. Kjo e drejtë ankimimi mbetet mënyra e vetme për komunikimin me botën e jashtme. Aksesit në drejtësi dhe kontakti me përfaqësuesit ligjorë gjithashtu janë çështje shumë të rëndësishme të cilat janë adresuar nga GJEDNJ në rastet e shqyrtuara kundër Italisë.

Duke marrë në konsideratë periudhën 1-vjeçare të zbatimit të këtyre masave, lind nevoja për konsolidimin e një sistemi monitorimi të brendshëm profesional dhe efektiv i cili do të ndiqte zbatimin e kësaj mase shtrënguese dhe përgatitjen e informacionit nga ana e strukturave penitenciare. Në këtë mënyrë, strukturat penitenciare konsolidojnë pozicionin e tyre për administrimin e këtyre masave me efektivitet dhe në përputhje me qëllimet ligjore për të cilat janë ndërmarrë ato.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se, “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për

⁹ <https://rm.coe.int/16809986b4> Report of the CPT’s 2019 ad hoc visit in Italy, page 34
<https://www.crimetalk.org.uk/index.php/library/articles/983-anti-mafia-in-italy-the-41-bis-prison-regime>

vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe, në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se,

*“2. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca:
b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”.*

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për ngritjen e një grupi pune për rishikimin e Rregullores të Regjimit të Posaçëm të Sigurisë së Lartë në IEVP, miratuar me urdhër nr.380, datë 19.07.2019 të Ministrit të Drejtësisë, **e cila duhet të sqarohet, në përputhje me ndryshimet e reja ligjore të qershorit 2020, të drejtat bazë, përgjegjësitë, kushtet e zbatimit dhe monitorimit të brendshëm të regjimit të posaçëm, si dhe garantimin e një sistemi efektiv ankimor.**
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për miratimin e programit individual të këshillimit psiko-social të të burgosurve në regjimin e posaçëm, njoftimin e të dënuarit dhe marrjen e pëlqimit me shkrim për pjesëmarrjen në program.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për pasurimin e bibliotekave të të burgosurve në regjimin e posaçëm, me larmi titujsh të librave të cilët duhet të vihen në dispozicion të të burgosurve.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e dhomave të veçanta të edukimit psiko-social në çdo seksion.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për rishikimin e urdhërit të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë nr.104/5 prot., datë 19.07.2006 dhe Ministrit të Shëndetësisë nr.205 prot., datë 27.07.2006, “Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit”, duke shtuar larmishmërinë dhe rritur në mënyrë të veçantë kuotat ushqimore për personat e transferuar në regjimin e posaçëm, por jo vetëm. Deri në rishikimin e këtij urdhëri, të merren masat e menjëherëshme që personat e ndodhur në këtë regjim të kenë mundësinë për të marrë ushqime nga jashtë në mënyrë që të mos u cënohet e drejta për ushqim dhe dietë të përshatshme.
6. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e sallave të forcës në të dy seksionet e regjimit të posaçëm, për kalimin e një pjese të kohës në ushtrime fizike.
7. Marrjen e masave për eliminimin e lagështirës në dhomat e banimit ku ky problem u evidentua. Deri në zgjidhjen e këtij problemi të shihet mundësia e

përdorimit të qelive në katet e tjera përse rezultoi se kishte kapacitete të lira në godinë.

8. Përmirësimin e kushteve të përgjithshme të qëndrimit në lidhje me orenditë që nevojiten për të siguruar një standard minimal të përshtatshëm në kushtet kur të paraburgosurit dhe ose të dënuarit vendosen në kushtet e ndalimit të kontakteve sociale dhe qëndrimit të zgjatur brenda dhomave të caktura për ta. Këto përmirësime duhet të përfshijnë edhe krijimin e kushteve minimale rekreative dhe informuese të përgjithshme që të zëvendesojnë mungesën e kontakteve sociale. Rishikimin e përmasave të tavolinave të cilat nuk janë të përshtatshme për të kryer funksionin e tyre.
9. Organizimin e punës për të siguruar higjienën e përshtatshme në ambientet e përbashkëta.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, në bazë të nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA